



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2025/0089

Paneli Shqyrtues i Organit Shqyrtues të Prokurimit, në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga, Isa Hasani, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE “GMM Group” SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës” me numër të prokurimit; 214-24-13221-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës, më 21/02/2025, mori këtë:

Vendim

1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar ankesa e OE GMM Group SH.P.K. me nr. 2025/0089, e datës 03/02/2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës”, me numër të prokurimit 214-24-13221-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues – Policia e Kosovës.
2. Mbetet në fuqi, B58 Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues - dt.23.01.2025, Policia e Kosovës për aktivitetin e prokurimit “Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës”, me numër të prokurimit 214-24-13221-2-2-1.
3. Lejohet kthimi i tarifës për ankesë, në vlerën e deponuar për paraqitjen e ankesës, operatorit ekonomik OE "GMM Group" SH.P.K, sipas nenit 31.4. OE obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për tërheqje të depozitës për sigurim të ankesës, në të kundërtën bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

Policia e Kosovës, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 24.12.2024 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Shërbimet për pastrimin

e automjeteve policore për regjionin e Prishtinës”, me numër të prokurimit 214-24-13221-2-2-1.

Autoriteti Kontraktues në këtë rast ka zhvilluar procedurë të hapur të prokurimit lloji i kontratës për punë me vlerë të parashikuar e kontratës prej 124,000.00 €.

AK me datën 23.01.2025 ka publikuar Njoftimi mbi vendimin e për dhënie të kontratës OE “Leicon” SHPK.

OE “GMM Group” SH.P.K me datën 27.01.2025 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për dhënie të kontratës. AK me datën 28.01.2025 ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim te OE.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 03.02.2025 operatori “GMM Group” SH.P.K ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2025/0080 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP-së.

(b) Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka caktuar Panelin Shqyrtues sipas nenit 111, paragrafi 5 (ii) të LPP dhe ka angazhuar ekspertin shqyrtues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 (i) të LPP, me detyrë që i njëjti ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me këtë aktivitet të prokurimit, në kuptim të nenit 113 dhe 114 të LPP lidhur me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së cituar. Lidhur me këtë, me 11.02.2025 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit rekomandime të cilat përshkruhen si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar,
- Të mbetet në fuqi vendimi për dhënie të kontratës.

Përgjigje e Autoritetit Kontraktues në pretendimet ankimore të OE “GMM Group” SH.P.K

AK nuk ka bërë shkelje të neneve të lartë përmendura pasi gjatë vlerësimit të ofertave janë respektuar të gjitha dispozitat e LPP-se, në vijim japim sqarime të detajuara: Pretendimet se AK ka shkelur nenin 1 Qëllimi të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se në mënyre me të drejt dhe efikase të shfrytëzimit të fondeve publike, duke publikuar njoftimin për kontrate me procedure te hapur duke mos diskriminuar ose favorizuar asnjë OE, për këtë aktivitet te prokurimit. AK ka siguruar integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë

që kanë kryer aktivitetin të prokurimit dhe që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim. Këta persona zyrtarë që kanë kryer aktivitetin e prokurimit, janë sjellë duke ndjekur parimin e shfrytëzimit sa më efikas, me kosto ekonomike, transparent dhe të drejtë të fondeve dhe burimeve publike duke iu përmbajtur rreptësisht procedurave dhe kushteve qenësore të këtij ligji. Komisioni i vlerësimit të ofertave ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe ka rekomanduar Operatorin Ekonomik që ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara si dhe me çmim me të ulët se oferta e juaj. Oferta e juaj është e ofertë e përgjegjshme me çmimin me të lartë se oferta e rekomanduar për kontratë. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimin se AK ka shkelur nenin 6 të LPP, nuk qëndron pasi AK, të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Në këtë aktivitet të prokurimi Autoriteti kontraktues duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit fondet publike i ka përdorë në mënyrën ekonomike pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe ka çmimin me të ulët si ofertë e përgjegjshme ndërsa oferta e juaj është ofertë e përgjegjshme me çmimin me të lartë. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se Autoriteti kontraktues do të trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ku të gjithë Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktiviteti i ka trajtuar të barabartë. Po ashtu AK, sqaron se gjatë udhëheqjes së aktiviteteve të prokurimit, të gjitha autoritetet kontraktuese do të sigurojnë: vi) që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse pasi që oferta e rekomanduar për kontratë i plotëson të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Andaj, Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konform kërkesave të kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe ka rekomanduar për kontratë OE që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë dhe çmimin me të ulët si ofertë e përgjegjshme. Andaj, komisioni i vlerësimit të ofertave të gjithë ofertuesit duke ju përfshirë edhe juve si ankues ju kanë trajtuar të barabartë dhe nuk ju kanë diskriminuar sipas LPP pasi që oferta e juaj është e ofertë e përgjegjshme me çmimin me të lartë se oferta e rekomanduar për kontratë. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimet se AK ka shkelur nenin 59 të LPP-ës, nuk qëndron pasi AK, sqaron se nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi që vlerësimi i ofertave është bërë në harmoni me Ligjin e Prokurimit Publik, konforme kriterëve të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Komisioni i vlerësimit ka bërë vlerësimin e ofertave konforme kërkesave të kërkuara në dosjen e tenderit, njoftimit për kontratë dhe ka rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik që i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara si dhe me çmimin me të ulët se oferta e Juaj. Oferta e Juaj i ka plotësuar të gjitha kriteret e kërkuara në njoftimi për kontratë, dosjen e tenderit mirëpo keni çmimin me të lartë se oferta e rekomanduar për kontratë. Sa i për këtë pretendimit ankimore se OE i rekomanduar nuk ka lëshuar deklaratë të vulosur dhe të nënshkruar për pikën në Mutivode se ku do të pastrohen automjetet e këtij kufiri, AK ju sqaron se nuk është kërkuar që për këto dy pika Kufitare në Merdare dhe Mutivodë të dëshmohej me deklaratë të vulosur dhe të nënshkruar pasi që te ANEKSI 1 specifikacinet teknike të detyrueshme është kërkuar që Kufiri - (Merdare, Mutivoda në pikën më të afërt) nga kjo shihet që këto dy pika të Kufirit pastrimi i automjeteve do të behet në pikat me të afërta të autolaijeve. Pretendimi tjetër që autolaija ka një distance 4.2 km nga Stacioni

Policore ju njoftojmë se ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate nuk ka qene kërkesë distanca e autolaijeve prej Stacionit Policore. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar. Pretendimet për shkelje të Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës është zbatuar në përpikëni të plot pasi që Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontrate është ofertë e përgjegjshëm me çmime me të ulët ndërsa oferta e Juaj ka çmimin me të lartë. Pretendimi juaj është plotësisht i pa bazuar.

Pretendimet se AK ka bërë shkeljen e nenit 72 të LPP, Ju ne kërkesën për rishqyrtim nuk keni shtjelluar këtë nenë pse është shkelur ndërsa, AK sqaron se nuk ka bërë shkelje pasi që për asnjërin OE pjesëmarrës në këtë aktivitet nuk është paraqitur nevoja për të kërkuar sqarime shitesë në lidhje me cilindo dokumentacion të ofruar nga Operatorët Ekonomik pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit. Pretendimi ankimor është i pa bazuar.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues "GMM Group" SH.P.K ne ankesën Nr. 0089/2025 janë parashtruar si në vijim:

Me rastin e mos rekomandimi te kompanisë tonë për dhënie te kontratës Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës ka bërë këto shkelje:

Me datën 23.01.2025 kemi pranuar njoftimin mbi vendimin tuaj, ku keni rekomanduar për kontratë Lecion SH.P.K i cili nuk i plotëson kriteret e kërkuara te përcaktuar nga ana juaj ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontrate:

Neni 1 - Qëllimi i LPP-se- Qëllimi i këtij ligji është të siguroj mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga personat, operatorët ekonomik, ndërmarrjet, autoritetet kontraktuese, koncesionerët e punëve dhe organet publike që zhvillojnë, përfshihen, marrin pjesë ose interesohen, në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti: Të gjitha autoritetet kontraktuese, janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe lëndën e prokurimit. Ndërsa Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 6 pasi ka rekomanduar për kontrate një Operator Ekonomik i cili nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftim për kontrate, qe do te thotë nuk është sipas dispozitave te LPP-se.

Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi- Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente. Autoriteti kontraktues nuk do të ekzekutojë asnjë aspekt të aktivitetit të prokurimit në një mënyrë që redukton apo eliminon konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik ose që diskriminon në dëm ose në të mirë te një ose më shume operatoreve ekonomik. Autoriteti Kontraktues duke na Diskriminuar ne si Operator Ekonomik te përgjegjshëm dhe kane zgjedhe ta shpërblejnë për kontrate një Operator qe nuk i plotëson kriterete e kërkuara ne Dosje te Tenderit dhe ne Njoftim për kontrate.

Autoriteti Kontraktues Policia e Kosovës nuk ka respektuar dispozitat e LPP-se duke rekomanduar për kontratë Operatorin Ekonomik Lecion SH.P.K duke pasqyruar se ky OE nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara pasi që adresa e autolarjes e kërkuar në dosje të tenderit përcakton se autolarja duhet të jetë në Podujevë, ndërsa OE Lecion SHPK ka dorëzuar një lokacion për pastrim të automjeteve në një fshat larg Podujevës, me distancë 4.2km larg nga stacioni policor në Podujevë, andaj me këtë lokacion krijohen shpenzime të automjeteve për pastrim të veturave dhe mund të shkaktoj vonesa të ndryshme gjatë orarit të punës, pasi që kërkesa e AK-se është që t'i këtë prioritet kryesor automjetet për pastrim, andaj duke pasqyruar se në dosje të tenderit është kërkuar tre (3) lokacione brenda Komunës së Prishtinës për të mos pasur këto lloje shpenzime pasi që autolarja me lokacion në Vranjevc është vetëm 2km nga qendra dhe prapë është kërkuar që të këtë vend punishte në këtë lokacion poashtu edhe në lokacionin e Emshirit.

Autolarja e cila është dorëzuar me baze në qendër të Prishtinës mendojmë që nuk i plotëson kriteret për vendpunishte pasi që nuk ka parking të mjaftueshëm për automjete të PK-se, duke ditur kërkesën e shumtë për pastrim të tyre. Prandaj, mendojmë që nuk është i përshtatshëm pasi që nuk ka vend parkime të mjaftueshme për hapësirat që zënë këto vetura. OE nuk ka lëshuar deklarate të vulosur dhe nënshkruar për piken në Mutivode se ku do të pastrohen automjetet e këtij kufiri. Autoriteti kontraktues nuk ka kërkuar që të bëjë verifikimin e largësisë nga stacionet policore dhe vend punishteve.

Duke pasqyruar natyrën e automjeteve të PK-se dhe mjetet e punës që bëjnë në veturat e tyre duke përfshirë armët, fishekët, rrobat, letrat konfidenciale, supozojmë (mendojmë) se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të rënde pasi që ka pranuar një kontratë e cila gjendet me lokacion në Emshir dhe sipas burimeve që i posedojmë ky kontraktor ka vepra penale për të cilat akuzohet dhe është i dënuar andaj si është e mundur që të pranohet një kontratë e tillë duke rrezikuar sigurinë e automjeteve të policisë dhe vete ata? Kontrata e nënshkruar dhe dorëzuar nga Lecion SHPK me nr. unik identifikues: 812053958 lidh kontratë me këtë person: Veli Gashi me nr personal: 1250895638 i cili supozohet (mendohet) që posedon vepra penale gjë që është në kundërshtim me ligjin. Andaj, kërkojmë nga organi shqyrtues i prokurimit të merret me rastin në fjale pasi që është një kontratë e kundërligjshme një situatë e tillë.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashitjet dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur në neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë 05/02/2025 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0089/2025, i cili është dorëzuar me datë 11/02/2025.

Lidhur me pretendimet e OE "GMM Group" SH.P.K eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2025/0089 ka vlerësuar si në vijim:

Operatori Ekonomik ankues në ankesë e kundërshton ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për dhënien e kontratës në procedurën e prokurimit: "Shërbimet për pastrimin e automjeteve policore për regionin e Prishtinës", me nr. të prokurimit: 214-24-13221-2-2-1, dhe

pretendon se OE i rekomanduar nuk ka prezantuar marrëveshjet mbi marrjen me qara, sipas kritereve të vendosura nga AK, në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë. Eksperti shqyrtues sqaron se AK – Policia e Kosovës, për këtë procedurë të prokurimit në kërkesën nr. 3 tek Kapaciteti Teknik dhe Profesional është kërkuar: “Kërkesa 1: Operatori ekonomik është i obliguar që të ketë autolarje në secilën komunë sipas kërkesës së Autoritetit Kontraktues të përshkruara në dosje të tenderit në specifikat teknike Aneksi 1 (OE nëse nuk ka autolarje të vetën është i obliguar të ofrojë dëshmi mbi marrjen me qara apo marrëveshje për shfrytëzim për ofrimin e shërbimeve të kërkuara) marrëveshjet duhet të jen të noterizuara dhe në afat kohor prej 36 muajve.

Dëshmi 1: OE duhet të ofrojë dëshmi me shkrim se ku mund të bëhet pastrimi i automjeteve nëpër komuna – për Regjionin. Nëse OE nuk ka objekt të vetin nëpër komuna atëherë duhet të ofrojë kontratë ose marrëveshje në mes të OE dhe pronarit të autolarjes ku do të bëhet pastrimi për secilën Pjesë marrëveshjet duhet të jen të noterizuara dhe në afat kohor prej 36 muajve”. Eksperti shqyrtues sqaron se OE i rekomanduar për dhënien e kontratës në ofertë ka prezantuar marrëveshjet ashtu siç ka kërkuar AK në njoftimin për kontratë si dhe në dosjen e tenderit.

Marrëveshjet mbi qiranë të noterizuar si më poshtë:

1. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Drenas, Rruga Bejt Rexhepi me pronar Berlet Sejdiu
2. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Fushe Kosove, Rruga Fehmi Lladrovci (përball postes), me pronar Adem Karaxha,
3. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Graçanicë- Rruga Graçanice-Prishtine, me pronar Idriz Vrajolli,
4. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 13.01.2025, Podujeve, Rrugën Podujeve-Merdare, me pronar Fatlum Behrami,
5. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Lipjan, Rruga Bajram Gashi 108, me pronar Burhan Jashari,
6. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Obiliq, Rruga Hasan Prishtina 52, me pronar Qefser Morina,
7. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 13.01.2025, Podujeve, Magj. Podujeve-Prishtine me pronar Ekrem Haliti,
8. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Prishtine, Rruga Lidhja e Prizrenit nr.19, me pronar Rinor Brahimi,
9. Marrëveshja bashkëpunimi e datës 15.01.2025, Prishtine, Rruga Ahmet Krasniqi pn, me pronar Driton Dauti.

Pretendimet tjera janë se OE i rekomanduar për kontratë nuk ka përmbushur kilometrat dhe nuk ka ofruar deklaratë të vulosur dhe nënshkruar për piken në Mutivode, se ku do të pastrohen automjetet e këtij kufiri. Eksperti shqyrtues sqaron pretendimet ankimore të OE ankues, ku AK - Policia e Kosovës në dosje të tenderit nuk ka përcaktuar kilometrat për pikat të autolarjes dhe për pikën në Mutivodë nuk ka kërkuar marrëveshje - deklaratë të vulosur, por ka sqaruar në FDT tek

Aneksi 1. që pika në Mutivodë të pastrohen automjetet në pikën më të afërt, andaj, këto pretendime janë të pa bazuara.

Eksperti shqyrtues vlerëson se AK - Policia e Kosovës, ka respektuar dhe vepruar konform nenin 7 dhe 59 të LPP-së dhe ka bërë vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin ofertave duke u bazuar në depozitat ligjore të LPP-së.

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues, Ankesa e OE ankues të refuzohet si e pabazuar, Të mbetet në fuqi vendimi për dhënie të kontratës.

Raportin e ekspertizës e kanë pranuar të dyja palët procedurale përmes sistemit të e-prokurimit ku autoriteti kontraktues është pajtuar me mendimin e dhënë në raportin e ekspertizës ndërkaj operatori ekonomik nuk është deklaruar për mendimin e dhënë të ekspertit shqyrtues.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjyqimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorit ekonomik ankues OE "GMM Group" SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorit

ekonomik ankues OE "GMM Group" SH.P.K , janë të pa bazuara.

Në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin pjesërisht konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues janë pjesërisht të bazuara, nisur në faktin se marveshtja e bashkpunimit për qirat është kërkuar për gjitha pikat e autolarjes, jo për një pikë Dosja e tenderit, jo uformitet kërkesës. Andaj, Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik duhet aprovohet si pjesërisht e bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, i dates, 23.01.2025, për shpërblim me kontratë OE"Leicon" SH.P.K. për aktivitetin e prokurimit.

Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, Policia e Kosovës, lidhur aktivitetin e prokurimit "Shërbimet për Pastrimin e Automjeteve Policore për Regjionin e Prishtinës", me nr. të prokurimit: "214-24-13221-2-2-1"1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – Policia e Kosovës.

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlerësimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2025/0089, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin aprovimit të pjesërisht të ankesës të OE "GMM Group" SH.P.K vendosi të kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatori ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 4 të Rregullores së Punës së OSHP.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Isa Hasani

Hasani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - GMM Group SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: